




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-4078/14
Dep. 02 Br. Prot. Prot No
Nr. i faq. 02 Data 11.11.2014
Broj stranica 02 Datum 11.11.2014
Nr. pages 02 Date 11.11.2014
PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	10.11.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Agron Thaqi – Kryeshef Ekzekutiv në NP. Infrakos sh.a.
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preni – Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Thaqi

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-3721/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin "rast për rast të interesave", (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Kërkesa e juaj, ka të bëjë me sqarimin, respektivisht marrjen e një opinionit nga Agjencia kundër Korrupsionit, lidhur me një situatë të cilën ju e keni konsideruar si konflikt të mundshëm

Faqe 1 nga 1

interesi, e për të cilën ne edhe në vitin 2012, konkretisht me 22.08.2012 (Z.D./DPK-01-3003/12) kemi dhënë një Opinion.

Situata të cilën e keni përshkruar ju, duke deklaruar se keni një staf të punonjësve që shfrytëzojnë banesat e kompanisë që nga koha e pas luftës dhe të cilët tani kanë pozita menaxhuese në Infracos, nuk ka të bëjë fare me situatë të konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në edhe në Opinionin e datës 22.08.2012 kemi përshkruar në mënyrë të detajuar situatat kur një zyrtar i lartë mund të gjendet në situatë të konfliktit të interesit.

Për këtë rast ju brenda Ndërrmarrjes tuaj keni pas edhe një Komision të veçantë për verifikimin e konflikti të interesit, i cili në njoftimin për punën e tij, të datës 18.09.2012, ka deklaruar se: "Komisioni ka analizuar Opinionin dhe nuk ka vërejtur se rastet e dyshuara paraqesin konflikt të interesit". (DPK/DPKI-03-3899/14).

Që nga atëherë situata nuk ka ndryshuar as sa i përket ofrimit të fakteve të reja, e as sa i përket legjislacionit në fuqi që e rregullon këtë çështje.

Për më tepër ne kemi kontaktuar individualisht edhe tre zyrtaret e juaj që në këtë rast janë palë të përfshira në këtë proces dhe ato kanë ofruar informacione të mjaftueshme (Dpk/DPKi-03-03-3899/14 dhe DPK/DPKI-03-3951/14), nga të cilat po ashtu kemi vërtetuar se kjo çështje nuk mund të cilësohet e as të trajtohet fare si konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt,

